KIRFN Interpretimi 6
Detyrimet që rrjedhin nga pjesëmarrja në një treg specifik – Mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike

Referencat

- SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*
- SNK 37 *Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara*

Konteksti

1 Paragrafi 17 i SNK 37 specifikon që një ngjarje detyruese është një ngjarje e shkuar që krijon një detyrim aktual për të cilin një njësi ekonomike nuk ka asnjë alternativë tjetër, veçse ta shlyejë atë.

2 Paragrafi 19 i SNK 37 shprehet se provizionet njihen vetëm për 'detyrimet që lindin nga ngjarje të shkuara që ekzistojnë pavarësisht nga veprimet e njësisë ekonomike në të ardhmen'.

3 Direktiva e Bashkimit Evropian mbi pajisjet elektrike dhe elektronike të nxjerra nga përdorimi (PE&ENP), e cila rregullon grumbullimin, trajtimin, rikuperimin dhe sistemimin për efekt mjedisor të këtyre pajisjeve, i jep shkas pyetjes se kur duhet të njihet detyrimi për nxjerrjen e tyre nga përdorimi i PE&ENP. Direktiva bën dallimin midis nxjerrjes nga përdorimi 'të re' dhe asaj 'historike' dhe midis nxjerrjes nga përdorimi të pajisjeve shtëpiake vetjake dhe asaj nga burime të tjera. Nxjerrja e re nga përdorimi ka të bëjë me produktet e shitura pas 13 gushtit 2005. Të gjitha pajisjet shtëpiake të shitura para kësaj date krijojnë shpërdorime historike për efekt të Direktivës.

4 Direktiva përcakton se kostoja e drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi i pajisjeve shtëpiake historike duhet të përballohet nga prodhuesit e asaj lloj pajisjeje që është në treg gjatë një periudhe që specifikohet në legjislacionin përkatës të secilit prej shteteve anëtare (periudha e matjes). Direktiva përcakton që secili prej shteteve anëtare të vendosë një mekanizëm që prodhuesit të kontribuojnë në kosto në mënyrë përpjesëtimore 'p.sh. në përpjesëtim me pjesën e tyre përkatëse të tregut sipas llojit të pajisjes.'

5 Disa nga termat e përdorur në Interpretim si 'pjesë tregu' dhe 'periudhë matjeje' mund të përkufizohen në mënyra të ndryshme në legjislacionin e zbatueshëm nga shtetet anëtare të veçanta. Për shembull, kohëzgjatja e periudhës së matjes mund të jetë një vit ose vetëm një muaj. Në mënyrë të ngjashme, matja e pjesës së tregut dhe formula e llogaritjes së detyrimit mund të jetë e ndryshme në shumë prej legjislacioneve kombëtare. Megjithatë, të gjithë këta shembuj prekin vetëm matjen e detyrimit, i cili nuk është brenda objektit të Interpretimit.

Objekti

6 Ky Interpretim jep udhëzimin mbi njohjen, në pasqyrat financiare të prodhuesve, të detyrimeve që kanë të bëjnë me drejtimin e nxjerrjes nga përdorimi sipas Direktivës së BE-së mbi PE&ENP, përsa i përket shitjeve të pajisjeve shtëpiake historike.

7 Interpretimi sqaron si nxjerrjet e reja nga përdorimi, ashtu dhe ato historike nga burime të ndryshme nga ato shtëpiake. Detyrimi, që lind si rezultat i drejtimit të këtyre nxjerrjeve nga përdorimi, trajtohet mjaftueshëm në SNK 37. Megjithatë, nëse, në legjislacionin kombëtar, nxjerrjet e reja nga përdorimi të pajisjeve shtëpiake trajtohen në mënyrë të ngjashme me ato historike, parimet e Interpretimit zbatohen duke i'u referuar hierarkisë në paragrafët 10–12 të SNK 8. Gjithashtu, hierarkia e SNK 8 vlen edhe për rregullimet e tjera që i ngarkojnë detyrimet në mënyrë të ngjashme me modelin e caktimit të kostos siç specifikohet në Direktivën e BE-së.

Çështja

8 Në kontekstin e nxjerrjes nga përdorimi të PE&ENP, KIRFN-së i'u kërkua të përcaktonte se çfarë përbënte ngjarje detyruese në përputhje me paragrafin 14(a) të SNK 37 për njohjen e një provizioni për kostot e drejtimit të këtyre nxjerrjeve:

- prodhimi apo shitja e pajisjeve shtëpiake historike?

- pjesëmarrja në treg gjatë periudhës së matjes?
- kostot e ndodhura gjatë kryerjes së aktiviteteve të drejtimit të nxjerrjeve nga përdorimi?

Konsensusi

9 Në përputhje me paragrafin 14(a) të SNK 37, pjesëmarrja në treg gjatë periudhës së matjes është ngjarje detyruese. Si rrjedhim, një detyrim për kostot e drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi të pajisjeve shtëpiake historike nuk lind kur produktet prodhohen ose shiten. Meqë detyrimi për pajisjet shtëpiake historike është i lidhur me pjesëmarrjen në treg gjatë periudhës së matjes, se sa me prodhimin ose shitjen e zërave për t'u nxjerrë nga përdorimi, nuk ka asnjë detyrim nëse dhe derisa ky treg nuk ekziston gjatë periudhës së matjes. Gjithashtu, kohëzgjatja e ngjarjes detyruese mund të jetë e pavarur nga periudha e veçantë në të cilën ndërmerren aktivitetet e drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi dhe kostot përkatëse të ndodhura.

Data e hyrjes në fuqi

10 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Interpretim për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 dhjetor 2005 e në vijim. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Interpretim për një periudhë që fillon përpara datës 1 dhjetor 2005, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Periudha kalimtare

11 Ndryshimet në politikat kontabël do të bëhen në përputhje me SNK 8.

 © IFRS Foundation